



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

---

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E LIRIMIT**

**LËNDA**

**“GJUHË FRËNGE”**

**VITI SHKOLLOR 2017 – 2018**

## **I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME**

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar dhe niveli i njohurive i përket **nivelet gjuhësor A2**, sipas dokumentit evropian “Kudri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët”.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës frënge, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e testit për gjuhën frënge si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe e shprehjeve të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor dhe leksikor) dhe funksional.

Programi orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve dhe zhvillimet e tyre personale, me qëllim që t’iu japë mundësi për sukses në provim.

### **Synimet e programit**

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësin e klasës IX, në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës frënge;
- të ndihmojë mësuesin në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve;
- të japë orientime për specialistët në hartimin e testit për gjuhën frënge;
- të vlerësojë dy nga katër aftësitë, të lexuarit e të kuptuarit, si dhe të shprehurit me shkrim përmes strukturave bazë të gjuhës, duke përfshirë aspektin morfologjik, sintaksor dhe leksikor.

### **Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit**

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, pasi nxënësi në provim do të përballë me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, megjithëse tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (la maison et l’environnement, la vie quotidienne, la nourriture, la santé, les voyages, les achats, les loisirs etc.)

Përsa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore (le nom, les adjectifs, les pronoms, la conjugaison des verbes: present, passé composé, imparfait, futur proche, le subjonctif, le conditionnel, le gerondif, etc.) duke dalë nga konteksti i mësimave ku këto probleme trajtohen.

Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me lloje ushtrimesh me alternativa, e herë me lloje ushtrimesh të hapura.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme, duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur për këto funksione gjuhësore.

Për sa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të shkruajnë mbi aspektet e përditshme, të bëjnë një përshkrim të shkurtër dhe elementar të një ngjarjeje, të veprimtarive të shkuara dhe të përvojave personale. Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë një seri frazash të sakta nga ana strukturore dhe leksikore të lidhura me lidhëza si: mais, et, parce que. Gjithashtu, mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet personale në një tekst koherent. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email, letër formale ose jo formale, një letër falënderimi, një ftesë etj., dhe të zbatojë rregullat e shkrimit.

## **II. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E GJUHËS FRËNGE**

Nxënësi duhet të demonstrojë aftësitë dhe njohuritë e tij për çka më poshtë vijon:

### **1. Të Lexuarit dhe të kuptuarit (Lire et Comprendre)**

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose joletrare, dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë çka i kërkohet.

Më poshtë po renditim disa aspekte të leximit:

- Përzgjedhja dhe marrja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të kërkuar.
- Përgjigjja e pyetjeve rreth përmbajtjes.
- Paraqitja e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.
- Gjetja e fjalëve referuese.

## **2. Të shprehurit me shkrim (Ecrire)**

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë jo shumë të gjerë temash duke i lidhur elementet në mënyrë koherente, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, një email duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej 60-80 fjalësh. Nxënësi vlerësohet për përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore, strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim në formën e një përshkrimi të thjeshtë, e një letre personale falënderimi, e një ftese, e përshkrimit të mjedisit të tij të përditshëm si: njerëzit, vendet, përvoja personale ose shkollore, si dhe rreth një game temash të njohura dhe të trajtuara ndër vite, në nivelin A2;
- shprehjen e pikëpamjeve në formë të thjeshtë dhe të qartë;
- përdorimin e një repertori të thjeshtë leksikor;
- komente të shkurtra dhe me fraza të thjeshta për probleme të ndryshme nga jeta e përditshme (description de la maison, des amis, des lieux, des événements etc.);
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar.

### 3. Përdorimi i gjuhës

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, janë dhënë përmes ushtrimeve, temave e bashkëbisedimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore dhe leksikore pra, kryesisht fjalori dhe gramatika e mësuar.

#### Llojet e ushtrimeve të rekomanduara për fushat e sipërpërmendura

<b>Të lexuarit dhe të kuptuarit (Compréhension des Écrits)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit</li><li>- Ushtrime me plotësim të vendeve bosh</li><li>- Ushtrime të tipit e saktë /e pasaktë (vrai ou faux)</li><li>- Bashkimi i elementeve të dy kolonave</li><li>- Gjetja e një informacioni në një tekst</li><li>- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve</li><li>- Ushtrime me disa alternativa (choisissez la bonne réponse)</li></ul>
<b>Përdorimi i gjuhës (Lexique et Grammaire)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Ushtrime me zëvendësim</li><li>- Ushtrime transformimi</li><li>- Ushtrime me shumë zgjedhje dhe alternativa</li><li>- Ushtrime me plotësime vendesh bosh</li><li>- Vendosja e fjalës së duhur në fjali</li></ul>
<b>Të shkruarit (Production Écrite)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Letër personale e thjeshtë</li><li>- Letër falënderimi</li><li>- Email</li><li>- Ftesa</li><li>- Mesazhe</li><li>- Përshkrime të thjeshta nga jeta e përditshme si: njerëz, vende, ngjarje</li></ul>

### III. STRUKTURA E PROVIMIT NË PËRQINDJE

<b>Aspektet gjuhësore që do të vlerësohen</b>	<b>Përqindja</b>
<b>Compréhension écrite</b> Të kuptuarit e një teksti të shkruar	<b>40%</b>
<b>Grammaire et lexique</b> Leksiku dhe gramatika	<b>40%</b>
<b>Production écrite</b> Të shprehurit me shkrim	<b>20%</b>

#### **IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

##### **Fushat tematike dhe leksiku**

Përmbajtja tematike e programit është mbështetur në programin dhe tekstet shkollore për gjuhën frënge. Tematika e parashikuar për provim përfshin temat bazë sipas kurrikulës dhe programeve, si edhe nëntemat që gjenden në tekstet e gjuhës frënge për shkollën 9-vjeçare.

- la maison et l'environnement
- l'école et l'éducation
- les voyages
- les loisirs
- la vie quotidienne
- les relations interpersonnelles
- les achats
- la santé
- la météo
- les moyens de communication.

##### **Leksiku**

Në bazë të temës përzgjidhet gjuha dhe aktet gjuhësore, si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit rreth një teme të caktuar. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për t'u shprehur thjesht me shkrim dhe me gojë.

### **Aktet dhe funksionet komunikuese**

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, të cilat shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikuese japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar ndër vite.

- Demander et donner des explications, des informations
- Donner et demander un avis, une opinion, p.ex.: je pense que, je crois que,...
- Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement
- Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements, p.ex.: d'habitude... chaque matin, d'abord..., après..., à la fin... etc.
- Demander et donner des conseils, p.ex.: Il ne faut pas faire cela!
- Exprimer la cause et la conséquence
- Exprimer le but (pour + inf.)
- Exprimer la condition et l'hypothèse
- Justifier une opinion ou une action
- Rapporter les paroles de quelqu'un

### **Elementet dhe strukturat gramatikore**

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore me gojë dhe me shkrim sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara deri tani:

- le présent des verbes du premier, deuxième groupe et des verbes irréguliers,
- l'imparfait et le passé composé,
- le futur
- le futur proche,
- le passé récent,
- le conditionnel présent,
- le subjonctif présent,
- le gérondif,
- l'impératif,
- le plus-que parfait
- la forme passive
- les expressions de la durée (depuis, pendant, il y a ...)

- le discours rapporté au présent.

### **Les pronoms**

- complément d'objet direct
- complément d'objet indirect,
- la place des deux pronoms: ex. Je le lui donnerai,
- les pronoms relatifs simples (qui, que, dont, où),
- les pronoms: y et en,
- le comparatif et le superlatif.

### **Les articles, les adjectifs et les pronoms**

- l'article défini, l'article indéfini, et l'article partitif,
- l'accord, le genre et la place de l'adjectif,
- l'adjectif et le pronom possessif,
- l'adjectif et le pronom démonstratif,
- l'adjectif et le pronom interrogatif,
- l'adjectif et le pronom indéfini.